

VENDIM
Nr. 236, datë 2.11.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR ‘ALBGAZ’ SHA”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 37, 50, 59, 68 dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të neneve 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të “Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 të Bordit të ERE-s dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga drejtoritë teknike, mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, certifikoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. si operator i kombinuar i gazit natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe të nenin 9, pika 6, të direktivës 73/2009 EC.

Shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk ka përmbushur kërkesat e vendimit sipërcituar, si vijon:

Pika 2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi “Albgaz” sh.a. të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE-s të Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MIE ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose të furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

Pika 3. “Albgaz” të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të vendimit Përfundimtar.

Pika 4. Paragrafi “...”, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas programit të përputhshmërisë rregullatore, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009 të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe të nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Pika 5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në opinionin e sekretariatit, “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE dëshmi që tregojnë garancinë, në lidhje me:

5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i ligjit “Për sektorin e gazit natyror dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë”. Për përmbushjen e këtij detyrimit, “Albgaz” sh.a. do t’i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i “Albgaz” sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur, janë efektive.

Pika 7. “Albgaz” sh.a. do të raportojë çdo 3 muaj në tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë te Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a., në pamundësi për të plotësuar kushtet e vendosura në vendimin ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 233/7 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017 deri në datën 10.4.2019 dhe bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin

e pikave të kërkuara në këtë vendim.

“Albgaz” sh.a. argumenton se shkak për mosplotësimin në kohë të kushteve të sipërpërmendura janë vonesat administrative nga institucionet e tjera, si: ZRPP, MIE etj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Afatet e përcaktuara në pikat 2, 3, 5, 5.2 dhe 7 të dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 8.11.2018, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të shtyhen deri në datën 10.4.2019.

2. Afati i përcaktuar në pikën 4, paragrafi “...”, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, raportin e përcaktuar sipas programit të përputhshmërisë rregullatore, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009 të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe të nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, shtyhet deri në datën 10.4.2019.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti